

Likovac, në spitalin e UÇK-së. Por, Fatmiri ndërroi jetë pas pesë minutash. Po atë ditë, familja e ka varrosur Fatmirin në varrezat e Likocit/Likovac, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata Z.V, FDH-13693; *Over 20 Albanians Killed in Latest Serb Offensive in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.08.1998, FDH-29429.

Sahit (Imer) Dajaku

(21.03.1913, shqiptar nga Rakinica/Rakitnica, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, një fëmijë)

Sahiti i moshuar me bashkëshorten Sadijen dhe familjen e të birit Musës jetonin në Rakinice/Rakitnica. Nga fundi i muajit korrik, situata në fshat nuk ishte më e sigurt për shkak të shtënave të shumta që dëgjoreshin rregullisht përreth tij. Për këtë arsye, bashkëshortja e Sahitit, e reja dhe nipërit kaluan në Klladërnice/Kladernica. Sahiti me Musën mbetën vetëm në shtëpi. Në datën **2.08.1998**, forcat serbe kanë hyrë në **Rakinice/Rakitnica**. Sahiti sërish nuk desh të largohej nga shtëpia e vet, edhe pse Musa me banorë të tjerë e braktisën fshatin dhe u strehuan në mal. Ishte kjo hera e fundit kur Musa e shihte të atin të gjallë. Tri ditë më vonë, forcat serbe u tërhoqën nga fshati. Musa u kthye në fshat, ky e gjeti shtëpinë e djegur. Në oborr, afro 15 metra larg shtëpisë, e ka gjetur trupin e pajetë të të atit, i cili ishte i ekzekutuar me dy plumba në shpinë. Një ditë më vonë, Musa e ka varrosur të atin me ndihmën e komshinjeve, në vendin e quajtur *Livadhi i Istrefit/Istrefova livada*. Pesë javë më vonë, më 13.09.1998, Musa e ka rivarrosur trupin e të atit në varrezat e fshatit, ku prehet edhe sot.

Burimi: deklarata M.D, FDH-17318.

Afrim (Sadri) Gashi

(26.12.1977, shqiptar nga Krusheva/Kruševac, komuna e Skënderajt/Srbica, i papunë, pjesëtar i UÇK-së)

Prindërit, vëllezërit dhe motrat e Afrimit e kanë braktisur Kruševën/Kruševac më 1.08.1998. Forcat serbe shtënin rregullisht me armë zjarri nga fshati fqinj i Polacit/Poljance mbi shtëpitë e banorëve. Afrimi me farefisën tjetër kanë mbetur në fshat. Ai

shkoi më **3.08.1998** te miqtë në *Mëhallën Vojvoda* në **Llaushë/Lauša**. Nga kjo ditë, nuk kishte asnjë gjurmë për të për një kohë të gjatë. Familjarët e kanë paraqitur zhdukjen e tij te OSBE-ja, por as kjo nuk u ndihmoi që të mësonin diçka për fatin e tij. Katër muaj më vonë [9.12.1998], një mik familjar e ka gjetur trupin e Afrimit te vendi i quajtur *Gradina e Vojvodëve* [Llaushë/Lauša]. Po atë ditë, familjarët e kanë bartur trupin e Afrimit në Kruševë/Kruševac dhe e kanë varrosur në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata S.G, FDH-13679; J. Martin-sen, *Registri...*, FDH-26092.

Branislav (Ljubomir)

Veselinović

(10.12.1972, serb nga Shabaci, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Branislavi me bashkëshorten Mirjanen, vajzën Marijen dhe prindërit Ljubomirin dhe Jasminen jetonin në Shabac. E kishte mbaruar shkollën për punë të brendshme dhe trajnimin për oficer të policisë rrugore. Punonte si pjesëtar i policisë rrugore pranë SPB-së në Shabac. Për të parën herë shkoi në Kosovë në fillim të muajit mars të vitit 1998. Në mbremje, më **3.08.1998**, familjes i është kumtuar zyrtarisht se Branislavi ka rënë në **Makërmal/Makrmalj**. Prindërit e kanë varrosur më 5.08.1998 në Varrezat e Reja në Shabac.

Burimet: deklarata Lj.V, FDH-27103; SMIP, *Teroristički...*, III, 442-445, 937; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 18; Politika, Branislav Veselinović, përkujtimi në shtyp, 5.08.1998, FDH-20742.

Zenel (Tahir) Meziu

(8.01.1972, shqiptar nga Marina, komuna e Skënderajt/Srbica, student, pjesëtar i UÇK-së)

Zeneli e studionte makinerinë. Familjarët e tij e kanë braktisur fshatin në muajin korrik të vitit 1998. Në bjeshkën e *Çiçavicës/Çiçavica*, ku ishin strehuar, ata mësuuan për rënien e Zenelit më **3.08.1998** në oborrin e Osman Meziut [**Marinë/Marina**], nga një granatë që e kanë hedhur forcat serbe. Një ditë më vonë, më 4.08.1998, familjarët e tij u kthyen dhe e varrosën Zenelin në fshatin Polac/Poljance, komuna e Skënderajt/Srbica.